

VENDIM
Nr. 967, datë 2.12.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË NUMRIN
E PUNONJËSVE BUXHETORË,
PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Kryeministrit për vitin 2015 shtohet me 20 veta përkatësisht, 10 punonjës për Agjencinë e Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog dhe 10 punonjës për Agjencinë Kombëtare për Zhvillim Rajonal (AKZHR), duke e çuar numrin total të punonjësve në 262 veta.

2. Shtesa e numrit të punonjësve, sipas pikës 1, përballohet nga pakësimi i numrit rezervë prej 12 vetash, i parashikuar në ligjin vjetor të buxhetit dhe nga reduktimi i 8 punonjësve të Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), duke e çuar numrin total të rezervës në 3 punonjës dhe numrin total të punonjësve të grupit buxhetor "Institucione të tjera qeveritare" në 429 veta gjithsej.

3. Numri i punonjësve të agjencive të përmendura në pikën 1, për vitin 2016, planifikohet në grupin buxhetor "Institucione të tjera qeveritare".

4. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga buxheti i akorduar për vitin 2015, për Kryeministrinë.

5. Ngarkohen aparati i Kryeministrit, Ministria e Financave dhe institucionet e lartpërmendura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama